

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"MITA INVEST" SHPK

Në Tiranë, sot më datë 16.10. 2024, (dymijë e njëzet e katër), unë i nënshkruari i mëposhtëm:

REI MITA, atësia Genci, amësia Alba, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Haxhi Hysen Dalliu; Nd. 6; H. 2; Ap. 24; Njësia Administrative Nr. 9; Njësia Bashkiake Nr. 9; 1016; Tiranë, lindur më 13/10/1995, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Letërnjoftim ID nr. 038056071 dhe nr. personal J51013071A.

me cilesinë e "Ortakut të vetëm Themelues", redaktoj këtë akt themelimi, nëpërmjet të cilit deklaroj se me vullnet të lirë të plote e të sinqerte dhe iniciativën e lirë private, mbështetur në Kushtetuten e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", në ligjin "Për QKB", në Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojnë shoqërinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, me emërtimin "**MITA INVEST**" shpk.

KREU I

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti

Neni 1

Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "**MITA INVEST**" shpk.

Neni 2

Forma Juridike

Shoqëria "**MITA INVEST**", është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur "Shoqëria"), e themeluar nga personi fizik i sipërpërmendur, i cili përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria "**MITA INVEST**" është një e tillë, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortakut i vetëm që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka selinë në Tiranë, rruga "Haxhi Hysen Dalliu", pallati 2, ap 24.

Shoqëria mund të ndryshojë seline e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, me vendim të Ortakëve të shoqërisë.

Neni 4

Objekti

Objekti i shoqërisë "**MITA INVEST**", do të jetë si më poshtë:

Shoqëria ushtron aktivitetin e saj me karakter thelbësor Investimet dhe Shërbimet, veprimtaria e saj ushtrohet në tre drejtime kryesore: Investimet, Shërbimet, Konsulenca & Përfaqësimi. Funksionimi i shoqërisë realizohet si: Investime në fushën e ndërtimit, objekte të gjitha natyrave dhe përfshire por pa u kufizuar në strukturat akomoduese dhe komplekset rezidenciale, porteve , aportoporteve si dhe sipërmarrje punimesh të çdo lloj natyre. Krijimi i pasurive të palujtshme, blerje/shitje , dhënie/marrje me qira, ndërmjetësim. (Agjenci Imobilare). Shërbime të Administrimit të Objekteve, mirëmbajtjes dhe administrimit të pronës së përbashkët. Ofrimi i shërbimeve të konsulencës për 2 shoqëritë e grupit, shoqëritë e kontrolluara prej saj dhe/ose të tretë, përfshirë por pa u kufizuar në konsulencë të natyrës menaxheriale, financiare, ligjore biznesi. Administrim dhe menaxhim në fushën e hotelierisë, restoranteve dhe bareve, përfshi këtu edhe hapjen e njësive të reja në të gjithë territorin e Shqipërisë. Shërbime të transportit privat si detar ashtu edhe tokësor si dhe shërbim taxi. Administrim dhe menaxhim në sistemet e shpërndarjes së ujit të pijshëm dhe largimin, përpunimin e ujërave të ndotura. Çdo lloj shërbimi në pastrim, shërbime hidraulike, elektrike, etj. Tregtim, import-eksport mallrash etj. Shitje suvenieresh, produkte artizanale të traditës dhe botime mbi trashëgiminë kulturore etj. Veprimtari në fushën e peshkimit, drejtim peshku. Shërbime të ndryshme në favor të të tretëve si konsulencë biznesi në fushën administrative, projektuese, teknike. Shërbime në fushën e pasurive të palujtshme, si vlerësime të certifikuar të pronës, strategji investimesh dhe risku , dhe çdo shërbim tjetër të natyrës juridike dhe financiare. Konsulencë të ndryshme biznesi dhe ndjekje të procedurave në fushën doganore & tatimore, bankare dhe financiare, prokurime publike, pasurive të paluajtshme , markat dhe patentat, e drejta e autorit , ndjekje të çështjeve gjyqësore në lidhje me to. Konsulencë juridike në marrëdhënie tregtare, juridike në fushën administrative, tregtare dhe financiare, civile, penale, konsulencë dhe mbajtje kontabiliteti, përgatitja e pasqyrave periodike dhe vjetore. Konsulencë juridike në përgatitje dokumentacioni , ndjekje e të gjitha procedurave për regjistrimin e shoqërive të krijuara rishtazi , deri në dhënie e licensës nga organi përkatës për fillimin e aktivitetit. Konsulencë të detajuar , përfaqësim të personave fizik dhe juridik, vendas apo të huaj , për çdo procedim administrativ, gjyqësor, jashtëgjyqësor, ekzekutim të vendimeve gjyqësore etj. Mbrojtje ligjore, përfaqësim i posaçëm dhe i përgjithshëm i klientëve, subjekteve fizik apo juridik , në konfliktet gjyqësore dhe administrative, në të gjitha shkallët e gjykimit, nëpërmjet avokatëve të punësuar pranë saj apo avokat, studio ligjore të kontraktuara. Bashkëpunim me avokatë, zyra avokatie apo çdo lloj forme tjetër organizimi brenda apo jashtë vendit. Bashkëpunim me një rrjetë të gjerë profesionesh të të gjitha llojeve si: noter, ekspert kontabël, topograf, vlerësues, projektues. Shoqëria do të ushtrojë, çdo veprimtari tjetër në përmbushje të objektit të saj.

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

KREU II , KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është **100 000 lekë (njëqind mijë lekë)** dhe është i përbërë nga **1 kuotë**. Kapitali i mësipërm është nënshkruar dhe shlyer tërësisht në të holla nga ortakët i vetëm i shoqërisë përkatësisht :

REI MITA, me nr. personal **J51013071A**, zotëruar i **1 (një) kuote**, me vlerë të përgjithshme **100 000 lekë (njëqind mijë lekë)**, që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakut të vetëm mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave të tretëve jashtë shoqërisë, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumicës së cilësuar që kërkon ndryshimi i statutit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimarrës

Ortaku i Vetëm është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë.

Ortaku i Vetëm është organi vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Ortaku i vetëm, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin dhe shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9

Marrja e vendimeve

Ortaku i vetem për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, vendos me votimin e tij. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasyqruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 10

Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga një administrator.

Administrator i shoqërisë është **REI MITA**, i cili do të ushtrojë funksionet në këtë detyrë për një periudhë 5 vjecare me të drejtë ripërtëritje.

Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 11

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikatat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi asamblenë e përgjithshme edhe në rastet kur :

- Asambleja e përgjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 13
Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Neni 14
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjisllacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 15
Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 16
Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemplare me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe dhe pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortaku i Vetëm themelues i shoqërisë tregtare "**MITA INVEST**", i cili deklaron se ka lexuar e kuptuar gjithçka në lidhje me këtë statut dhe e nënshkruan rregullisht atë në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tij orgjinale.

Ngarkohet **administratori, REI MITA**, per depozitim te ketyre akteve pranë QKB për rregjistrim.

ORTAKU I SHOQËRISË

REI MITA 

